



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

KKRF - Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar
KSFI - Kosovski Savet za Financijko Izveštavanje
KCFR - Kosovo Financial Reporting Council

Ligji Nr.06/L-032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim jep Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar (KKRF) autoritetin të themeloj regjimin për raportimin financiar të shoqërive tregtare në Kosovë, përfshirë çertifikimin e kontabilistëve dhe licencimin e auditorëve ligjorë. Sipas Ligji në fjalë, KKRF sipas funksionit mund të nxjerrë udhëzime administrative apo akte të tjera nënligjore që lidhen me funksionet e tijë. Bazuar në nenin 22 pika 1.1 të Ligjit, Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar nxjerrë këtë:

Njoftim

Njoftohen të gjitha shoqërit tregtare që janë subjekt i rregullimit nga ligji Nr. 06/L- 032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, se ligji i aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 30 Mars 2018, ka hyrë në fuqi nga data 1 Janar 2019 dhe do të prodhoj efekte juridike duke filluar nga kjo datë e tutje.

Pasqyrat financiare të shoqërive tregtare për vitin financiar që përfundon më datë 31.12.2018 do të trajtohen dhe rregullohen sipas kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-014 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 2013/02 mbi Strukturën dhe Përbajtjen e Pasqyrave Financiare.

Kryesues i KKRF-s

Afrim Maloku

Prishtinë

01.03.2019